



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 28/2020 (JR)

Tiranë më 12.03.2021

Nr. 28/2 regj.

**SHPALLJE**  
**E**  
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e martë, datë 30.03.2021, ora 10:00**, do të zhvillohet seanca gjyqësore publike për gjykimin e çështjes me nr. regjistri 28/2020(JR), datë 10.07.2020, që i përket ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 231, datë 29.01.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Anton Martini.

Seanca publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

<b>Kryesues</b>	<b>Ardian Hajdari</b>
<b>Relatore</b>	<b>Albana Shtylla</b>
<b>Anëtare</b>	<b>Natasha Mulaj</b>
<b>Anëtare</b>	<b>Rezarta Schuetz</b>
<b>Anëtar</b>	<b>Sokol Çomo</b>

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

**KRYESUES I TRUPIT GJYKUES**  
**GJYQTAR**

**ARDIAN HAJDARI**

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë, [www.kpa.al](http://www.kpa.al), e-mail: [info@kpa.al](mailto:info@kpa.al)

